



Vëllimi 3, Numri 9

Qershor 2022

BULETINI KUNDËR TERRORIZMIT

PËR BALLKANIN, RRETH BALLKANIT

NË KËTË NUMËR

Lajme dhe Informacione kundër terrorizmit 1

Luftëtari i huaj terrorist dënohet në Kosovë pas rigjykimit për herë të katërt - 2

Një holandeze dënohet në Shtetet e Bashkuara për pjesëmarrje në një Grup të Financimit të Terrorizmit - 2

Kombet e Bashkuara: Anketa Globale e Zbatimit të Rezolutës 1624 (2005) të Këshillit të Sigurisë nga Shtetet Anëtare- 2

Operacioni i Mburojës Trojane: Operacioni më i madh deri tani kundër përdorimit të paligjshëm të aplikacioneve të koduara - 3

Lajme dhe informacione lidhur me terrorizimin për përditësimin dhe komunikimin mes partnerëve tanë në rajon

Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ndihmës Zhvillimore dhe Trajnimit Prokurorial (OPDAT) në partneritet me Departamentin Amerikan të e Shtetit, Byroja e Antiterrorizmit

Në këtë numër raportojmë për dënimet më të fundit të Kosovës ndaj një LHT-je dhe për dënimin në Shtetet e Bashkuara të një gruaje që financon grupin terrorist al-Shabab me bazë në Somali. Ju ofrojmë, gjithashtu, edhe një pasqyrë të një raporti mbi mënyrën se po zbatojnë shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara Rezolutën 1624 për luftën ndaj nxitjes së terrorizmit. Në fund, flasim pak edhe për pajisjet Anom dhe për Operacionin e Mburojës Trojane, operacioni më i madh deri tani i forcave të zbatimit të ligjit në luftën ndaj përdorimit për qëllime kriminale të komunikimeve elektronike të koduara.

Tom Saunders
Këshilltar Ligjor kundër
Terrorizmit për Ballkanin

OPDAT/DOJ
Ambasada e SHBA
Sarajevë
SaundersTN@state.gov

Jasenska Ferizović
Këshilltare Ligjore
OPDAT/DOJ
Ambasada e SHBA
Sarajevë
FerizovicJ@state.gov

Clay Stiffler
Këshilltar Ligjor kundër
Terrorizmit për Ballkanin

OPDAT/DOJ
Ambasada e SHBA
Tiranë
StifflerRC@state.gov

Bledar Bashanoviq
Specialist Ligjor
OPDAT/DOJ
Ambasada e SHBA
Tiranë
BashanoviqB@state.gov

Luftëtari i huaj terrorist dënohet në Kosovë pas rigjykimit për herë të katërt

Më 13 maj 2022, një trup gjykues i Departamentit Special të Gjykatës së Prishtinës e shpalli fajtor të pandehurin Leunis Frangu për pjesëmarrje në një organizatë terroriste, duke e dënuar me tre vjet burg. Sipas aktakuzës, Frangu kishte udhëtuar për në Siri në vitin 2014, ku kishte mbështetur ISIS-in.

Vendimi në këtë rast erdhi pas disa gjykimeve të urdhëruara nga gjykata e apelit. Gjatë gjykimeve të mëparshme, gjykata kishte konstatuar se, megjithëse dëshmitë e dëshmitarëve kishin vërtetuar se Frangu ishte angazhuar në aktivitete të llojit ushtarak në Siri, provat nuk kishin qenë të mjaftueshme për të përcaktuar se në cilin formacion ushtarak kishte marrë pjesë. Prandaj, gjykata kishte vendosur të mos e dënonte për pjesëmarrje në një organizatë terroriste. Gjykata e Apelit e ndryshoi gjykimin, duke arsyetuar se i pandehuri kishte marrë pjesë në mënyrë të paligjshme në luftëra të huaja dhe se ligji në thelb ishte shkelur.

Në mbështetje të këtij rasti, OPDAT dhe FBI i ndihmuan prokurorët e Kosovës në gjetjen dhe marrjen e formularit të regjistrimit në ISIS të Frangut përmes kanaleve ndërkombëtare të ndihmës juridike. Formulari i regjistrimit u gjet mes sendeve të konfiskuara nga forcat e koalicionit—një burim i pasur provash të vlefshme të përdorura nga prokurorët e terrorizmit anembanë globit.

Burimi: [Herën e katërt shpallet fajtor i akuzuari për pjesëmarrje në luftërat e Sirisë, dënohet me tri vite burgim](#)

Një holandeze dënohet në Shtetet e Bashkuara për pjesëmarrje në një Grup të Financimit të Terrorizmit

Më 3 maj, një juri në Shtetet e Bashkuara dënoi shtetasen holandeze Fahria Hassan nën akuzat e financimit të grupit terrorist al-Shabaab me bazë në Somali.

Dëshmitë e paraqitura në gjyq treguan se Hassan, së bashku me një grup grash nga më shumë se një duzinë vendesh, drejtonin një grup të financimit të terrorizmit për më shumë se tre vjet. Ajo kishte mbledhur veçanërisht para në Holandë nën pretendimin e rremë se po mbledheshin për qëllime bamirëse. Hassan dhe anëtarët e tjera të këtij konspiracioni i qarkullonin fondet e mbledhura nëpërmjet transmetuesve të parave dhe kishin përdorur chat-in online për të koordinuar pagesat. Anëtarët e al-Shababit i kishin përdorur paratë për të financuar shtëpitë e sigurta dhe për blerje kamionësh dhe armësh në mbështetje të aktiviteteve të tyre terroriste.

Hassan u shpall fajtorë për komplotim në ofrimin e mbështetjes materiale një organizate të huaj terroriste dhe tani përballet me një dënim maksimal prej 15 vjetësh burg. Dënimi i saj do të shpallet në korrik. Dy anëtarë të tjerë që kishin bashkëpunuar me të janë dënuar gjashtë vjet më parë me 11 dhe 12 vjet burg.

Burimi: [Juria dënon shtetasen holandeze për pjesëmarrje në një Grup të Financimit të Terrorizmit](#)

Kombet e Bashkuara: Anketa Globale e Zbatimit të Rezolutës 1624 (2005) të Këshillit të Sigurisë nga Shtetet Anëtare

Rezoluta 1624 (2005) e Këshillit të Sigurisë të OKB-së u bën thirrje të gjitha shteteve të ndalojnë nxitjen për kryerjen e akteve terroriste dhe për ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe luftën ndaj nxitjes së terrorizmit. Kohët e fundit, është zhvilluar një studim global për të vlerësuar zbatimin e Rezolutës 1624 të UNSCR-së, rezultatet e të cilit janë publikuar nga Drejtoria Ekzekutive e Komitetit të Anti-Terrorizmit të Kombeve të Bashkuara (CTED). Ky studim konsideron gjithashtu dy rezoluta të Këshillit të Sigurimit të lidhura me të - Rezolutën 2178 (2014) dhe Rezolutën 2354 (2017) - të cilat i inkurajojnë Shtetet që ta adresojnë kërcënimin global të luftëtarëve terroristë të huaj duke zhvilluar programe për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe narrativat terroriste të përhapura nga ISIS, Al-Kaida, dhe

grupe të tjera terroriste.

Sipas CTED, Shtetet kanë bërë përparim të dukshëm “në ndalimin e nxitjes së kryerjes së akteve të terrorizmit dhe në ndërmarrjen e hapave përkatës për të parandaluar nxitjen e kryerjes së akteve të terrorizmit, për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm që favorizon terrorizmin dhe për të luftuar narrativat terroriste”. Që prej 1 marsit 2021, 112 Shtetet e kanë përfshirë nxitjen e terrorizmit si një akuzë penale të dallueshme në legjislacionin e tyre kombëtar, që paraqet përparim të rëndësishëm krahasuar me vetëm 76 shtete në vitin 2015. Në Evropën Juglindore gjashtë nga nëntë shtete kanë miratuar legjislacion për ndalimin e nxitjes së terrorizmit, ndërsa tre shtetet e tjera kanë parashikime për ndalesa të përgjithshme të nxitjes së sjelljes kriminale.

Megjithëse i vlerëson këto arritje të rëndësishme, CTED gjithashtu thekson se Shtetet duhet që të marrin që të gjitha masat në luftën ndaj nxitjes së kryerjes së akteve terroriste për të përmbushur detyrimet e tyre sipas së

drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në këtë drejtim, CTED nënvizon rëndësinë e përcaktimit me saktësi të qëllimit të veprës penale të nxitjes së akteve terroriste. CTED rekomandon “që vepra penale duhet të përfshijë shprehimisht si elementin subjektiv (qëllimin e veprës që con në kryerjen e aktit terrorist), ashtu edhe elementin objektiv (krijimin e rrezikut që të ndodhë kjo gjë realisht)”. Në këtë raport, CTED gjithashtu thekson se çdo problem me përkufizimin themelor të terrorizmit ose të akteve terroriste do të kishte ndikim negativ edhe në veprën penale të nxitjes së terrorizmit. CTED vë në dukje se disa shtete në Evropën Perëndimore dhe në Amerikën e Veriut parashikojnë si vepër penale "apologjitë" terroriste - domethënë justifikimin ose glorifikimin e akteve terroriste - gjë që është kritikuar nga mekanizmat e OKB-së për të drejtat e njeriut si një parashikim tepër i gjerë dhe që ndoshta shkel lirinë e fjalës duke “lejuar ndëshkimin e shprehjes që nuk krijon një rrezik objektiv të nxitjes së terrorizmit”. Problemet

me përkufizimet e paqarta dhe tepër të gjera të kësaj vepre penale janë regjistruar edhe në të gjitha nënrajonet e tjera, duke përfshirë edhe në Evropën Juglindore.

CTED vë më tej në dukje një rritje të konsiderueshme të numrit të komunikimeve që synojnë nxitjen e terrorizmit ose të dhunës që favorizon terrorizmin - duke përfshirë edhe ato që kanë për bazë ksenofobinë, racizmin dhe format e tjera të intolerancës - edhe pse Shtetet kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për të kundërshtuar të tilla komunikime. Ndërkohë, numri i sulmeve të kryera nga individë të lidhur me lëvizje dhe narrativa të tilla është rritur me 320 për qind pesë vitet e fundit. Kjo tregon se parandalimi dhe kundërshtimi i përhapjes së këtyre narrativave është “një sfidë e re dhe në rritje për Shtetet Anëtare”.

Burimi: [Anketa globale e zbatimit të rezolutës 1624 \(2005\) të Këshillit të Sigurisë nga Shtetet Anëtare](#)

Operacioni i Mburojës Trojane: Operacioni më i madh deri tani kundër përdorimit të paligjshëm të aplikacioneve të koduara

Kriminelët mendonin se po flisnin dhe po shkruanin mesazhe në pajisje të sigurta dhe të koduara. Në realitet, komunikimet e tyre i shkonin forcave të zbatimit të ligjit si pjesë e një përpjekjeje të paprecedent për të luftuar përdorimin e aplikacioneve të koduara për qëllime të paligjshme. Ky operacion i fshehtë, i njohur si Operacioni i Mburojës Trojane u bë publik vitin e kaluar. Tashmë, prokurorët anembanë botës po përdorin komunikimet e konfiskuara për të ndjekur rrjetet kriminale, drejtuesit e tyre dhe zyrtarët e korruptuar që i mbështesin.

Operacioni i Mburojës Trojane nisi në 2018-ën si produkt i të menduarit krijues nga forcat amerikane dhe australiane të zbatimit të ligjit. Operacioni përqendrohej rreth disa pajisjesh të programuara posaçërisht dhe të njohura si pajisje “Anom”. Anom ishte një aplikacion mesazhesh i instaluar në telefonat celularë Android. Pajisjet Anom tregtoheshin si të sigurta, të koduara dhe që nuk mund të aksesoheshin nga forcat e zbatimit të ligjit. Kriminelët i blinin këto pajisje - duke paguar deri në \$2,000 për një kontratë gjashtë mujore - duke menduar se mund t'i përdorin për të diskutuar aktivitetet e tyre të paligjshme pa rrezikuar kapjen e tyre. Ata e bënë këtë pa e ditur se komunikimet e tyre Anom shkonin në fakt në një server që mund të aksesoheshin nga forcat amerikane dhe australiane të zbatimit të ligjit. Si rezultat, forcat e zbatimit të ligjit mblodhën një sasi masive provash bindëse dhe të besueshme të veprimtarisë kriminale.

Në kulmin e këtij operacioni, në maj 2021, kishte mbi 11.000 pajisje me Anom të instaluar në mbarë botën. Ato përdoreshin nga rreth 300 sindikata kriminale në mbi 100 vende. Rreth 90% e përdoruesve të Anom ishin të angazhuar në veprimtari kriminale. Burimet mediatike gjithashtu raportojnë se komunikimet Anom zbuluan lidhje shqetësuese mes rrjeteve kriminale dhe zyrtarëve publikë

Nëpërmjet Anom, policia që në gjendje të lexonte miliona mesazhe, ku përshkruheshin komplete vrasjesh, trafikimi i

drogës dhe komplete të tjera kriminale. Duke komentuar mbi këto mesazhe, një komisioner Australian i Policisë Federale deklaroi, “Gjithçka që ata diskutojnë aty është droga, dhuna, goditjet ndaj njëri-tjetrit, [dhe] njerëz të pafajshëm që planifikohet të vriten”.

Operacioni i Mburojës Trojane doli më në fund hapur më 8 qershor 2021, kur forcat e zbatimit të ligjit në 16 vende ekzekutuan urdhër të shumta kërkimi dhe arrestuan mbi 800 të dyshuar falë provave nga pajisjet Anom. Gjithashtu, forcat e zbatimit të ligjit kapën tetë ton kokainë, 250 armë, dhe ekuivalentin e më shumë se 48 milionë dollarë në monedha të ndryshme dhe kriptovaluta. Në mbarë botën u përfshinë 9,000 oficerë policie.



Suksesi i Operacionit të Mburojës Trojane vazhdon të rritet pasi autoritetet shtetërore ndjekin provat, bëjnë arrestime dhe vazhdojnë me procedime penale. Këtë mars, për shembull, Shtetet e Bashkuara ekstraduan një person nga Holanda, i cili akuzohet për shpërndarjen e pajisjeve Anom në rrjetet e organizuara kriminale.

Operacioni i Mburojës Trojane ishte “operacioni më i madh deri tani i zbatimit të ligjit kundër komunikimit të koduar”, sipas Europolit. Tashmë, bota po sheh se si prokurorët po i përdorin provat e Mburojës Trojane.

Burimi: [Europol: 800 kriminelë arrestuar, Reuters: Telefonat spiun 'në xhepat e gangsterëve' tradhtojnë me qindra duke i nxjerrë zbuluar te Policia](#)